

Procesverbal

Nga seanca e IX-të (nëntë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 26.09.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e VIII-të e Kuvendit...,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021 dhe miratimin i Vendimit, për buxhetin e vitit 2019 me vlerësimet për vitet 2020 e 2021 për komunën e Dragashit, dhe
3. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarinimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse nuk ka, njëzëri, miratohet rendi i ditës.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...? Nëse jo, e miratojmë, pa vërejtje, Procesverbalin.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Pra, vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021 me miratimin e Vendimit për buxhetin e komunës së Dragashit për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021 e cilën e kemi shqyrtuar dhe lëshuar në diskutim publik në seancën e dt.28.06.2018 dhe, në ndërkohë, kemi mbajtur diskutimin publik më 29.07.2018, kurse reth buxhetit, janë kyçur edhe OSCE-ja dhe KDI-ja, të cilët i falënderojmë për kontributin e dhënë. Në këtë kontekst, kemi pra miratimin e Vendimit buxhetor/2019 dhe parashikimet për vitet 2020 e 2021, s' bashku me Listëbn e investimeve kapitale, të dala si rezultat i debateve të deritashme lidhur me buxhetin, hapim diskutimet...? Fillimisht, lidhur me ecuritë e deritashme reth kësaj pike fjalën eka kryetari i komunës z.Shaban Shabani, urdhëroni z.kryetar...

Kryetari- "I nderuar Kryesus, te nderuar anetare te Kuvendit dhe Ju te rrespektuar pjesmarres. Buxheti i Komunes se Dragashit per vitin 2019 mbështetet në Qarkoren Buxhetore Nr.2019/1,Qarkoren Buxhetore 2019/2 ,Planin mbi Realizimin e Mjeteve Vetanake të mbështetur në Rregulloren Komunale mbi grybullimin e mjeteve vetanake komunale, Ligjin mbi Tatimin në Prone dhe Kornizen Afatmesme Buxhetore të Shpenzimeve per periudhen 2019-2021. Sipas ketyre Dokumenteve, Buxheti i Komunes se Dragashit per vitin 2019 është **8,404,652.00 euro** në vitin 2020 Vlersohet të jetë **8,752,254.00 euro** ndersa ne vitin 2021 **9,116,509.00 euro** . Gjate ketyre tri viteve shtimi i mjeteve Buxhetore ka nje ngritje te lehte dhe kjo rritje nga viti ne vite është mesatarishte per 4.13%.Buxheti i Komunes Dragashti përbëhet nga Granti i përgjithshem. Granti specifik i Arsimit, Granti i shendetesise dhe të hyrat vetanake dhe huamarrjet Për vitin 2019. Granti i përgjithshem është 4,089,125.00 euro, i Arsimit 2,702,139.00 euro , i shendetesis 1,019,910 euro të Hyrat Vetanake 500,817 euro. dhe Huamarrjet 92,661 euro. Buxheti i Komunes se Dragashit ne raport me vitin paraprak eshte per 7.5% ma i madhe si rrjedhim i shtimit te grantit te pergjithshem dhe te ,grantit te shendetesise .Sipas kriterve Granti i Pergjithshem dhe ai i Shendetesise jane percaktuar ne baze te numrit te banorve dhe aspektit gjeografik kurse Granti per Arsim eshte percaktuar ne baze te numrit te nxensave. Sipas ketyre percaktimeve .Shperndarja e mjeteve nëpër kategori buxhetore për vitin 2019 do te jete keshtu ; për Paga 4.568.960 euro per Mallra dhe 868.908 euro Shpenzime komunale 130.000 euro ,Subvencione 50.000 euro dhe Shpenzime Kapitale per 2.786.784 euro.Si rrjedhim i kesaj shperndarje me Qarkoren buxhetore 2019/2 Mjetet e ndara per shpenzime kapitale jane ne proporcion me ato te vitei të kaluar, Burimi i finacimit te mjeteve per shpenzime kapitale sipas srukture do te jete 16.17% nga te hyrat Vetanake, kurse pjesa tjetet prej 83.83% nga Grantet e Qeverise. Mjetet per shpenzime kapitale jane percaktue ne listen e mjeteve per projekte kapitale .Lista e propozuar permbush dhe perfshin te gjitha kerkesat e qytetarve dhe vendbanimeve te kesaj komune. Kjo liste eshte produkt i propozimeve ne kontakt me qytetaret, Tubimit te rregullta te organizuara nga Kryetri i Komunes dhe ZKF me qytetaret e vendit dhe perfaqesuesit e fshtrave , degjimimeve publik me qytataret te mbajtur ne gusht te keti viti si dhe Planitit te zhvillimit te komunes si kerkese gjithperfshise e zhvillimit te infrastruktures komunale te kesaj Komune..Pagat si kategori buxhetore me buxhetin e propozuar ne rapot me buxhetin aktual jane me teper per 0.85% dhe permbushin kerkesen e numrit te puntorce te propozuar. Edhe pse kerkesat e puntorve ne arsim dhe shendetsi nuk mbulohen nga granti i arsimit, shendetsis i njejti mbulohet nga aj i përgjithshmi..Sa i perket shpenzimeve tjera per mallra dhe sherbime ,Shpenzime Komunale dhe subvencione ,mjetet e percaktuara jane ne kufijt e viti aktual . Pra, kjo strukture e buxhetit e propozuar per vitin 2019 dhe vitet ne vazhdim eshte si rrjedhim i politikave te Qeverise per te ruajt strukturen finaciare te buxhetit te Repubikes se Kosoves si dhe rrespektue prioritetet e Qeverise ne raport me strukturat finaciare nderkombtare. Në fund, per hire te debateve ,degjimeve dhe shqyrtimeve tjera qe kanë qene prezent rreth buxhetit gjete ketyre muajve si dhe diskutimit eventual Shpresoj se buxhetiti si propozim do te miratohet.Ju falemiderit."

z.Rexhep Kamberi- Unë dhe delegatët tjerë të komunitetit jo shumicë, kemi vërejtje në këtë buxhet. Sipas ligjit për shpërndarje të buxhetit, raporti i mjeteve në mes të komunitetit shumicë dhe jo shumicë duhet të jetë 57% me 43%, kurse, në këtë rast, për komunitetin shumicë janë paraparë 1.161.860,00 euro që me përqindje është 65% e, ndërsa për komunitetin jo shumicë 640.000,00 euro, që, me përqindje, janë 35%. Sipas kësaj, obligimi ligjor nuk po respektohet e që është dashur t'i takojnë 43% komunitetit jo shumicë. Për këtë, ne delegatët e komunitetit jo shumicë, kërkojmë nga ju z.kryetar që të bëhen korigjime dhe komunitetit jo shumicë t'i shtohen edhe 8% të mjeteve, për të mos pasur probleme lidhur me miratimin e këtij Vendimi. Siç e dini, kohëve të fundit, ministritë po na i këthejnë vendimet, se, në njëfar mënyre apo tjetrën, nuk po janë në harmoni me ligjet në fuqi. Ne, parimisht do të votjmë buxhetin, por do të kërkojmë nga drejtoratet, sidomos nga ai i Urbanizmit-ku hartohen projektet, që të bëhet harmonizimi me 8% në favor të komunitetit jo shumicë e që kjo do të ishte në rregull e që mos të jemi në situatë që MAPL-ja të na rikthen vendimet tona, si të paligjshme. Ndërkaq, sa u përket vetë parashikimeve, unë kam një sugjerim tek pikat 11 dhe 12 të ndërtimit murit mbojtës dhe kubëzimet në fshatin Gllloboçicë ku janë paraparë 25 mijë euro dhe te pika 12 ku ndërtimi dhe meremetimi rrjetit të ujësjellësit, ku janë paraparë 15 mijë euro, apo 10 mijë më pak se te pika paraprake. Pra, ideja është që shuma prej 25 mijë eurove të zvogëlohet për 5 mijë euro duke i përcjell tek projekti i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit në të njejtin fshat-Gllloboçicë, që pra mjetet të ngelin të njëjta për këtë fshat-40 mijë euro. Po ashtu, kam vërejtje edhe tek pikat 31 e 33 e që, në pikën 31, është vazhdimi i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit në Dikancë ku janë paraparë 10 mijë euro, që mendoj se janë mjete të vogëla, për këtë qëllim? Në anën tjetër, në pikën 33 kemi kubëzimin dhe infrastrukturës përcellëse në fshatin Baçkë, ku janë paraparë 20 mijë euro e që do të ishte më reale që kjo shumë të zvogëlohet për 5 mijë euro e që ato të orjentohen për në Dikancë? Unë medoj se këto vërejtje që dhash do të merrni në konsideratë, sidomos atë lidhur me ndarjen proporcionale në mes të shumicës dhe jo shumicës?

z.Laurat Krasniqi- Kryetari përmendi se fshati Brezne ka bërë korigjime të caktuara, e ne në kuadër të KAB-it, kemi paraparë 3 prioritete e që duhet të realizohen në bashkëpunim me ekzekutivin e Komunës dhe me ne përfaqësues të fshatrave. Është e vërtetë se fshati Brezne nuk ka kanalizim dhe, gjithësesi, se, nga dikund, duhet filluar. Ne i kemi paraparë 25 mijë euro e për këtë qëllim, ndoshta, do të kushton dukshëm më lirë e që duhet pasur parasysh rishikimin e buxhetit dhe s'di se sa do të lejon këtë pushteti qendror e ne kemi paraparë shumën e përgjithshme prej 75 mijë eurove, që kjo të ndahet në 3 pjesë proporcionale. Trolli i paraparë, për varrezat e fshatit, ndoshta, do të paraqet problem, pasi se ajo gjendet nën menaxhimin e AKP-së dhe, me sa e di unë, Komuna është në kontest me AKP-në lidhur me këtë troll dhe se po them se ne, si fshat, nuk kemi hapësirë të mjaftueshme për varreza dhe se, ndoshta, participimi i fshatit nuk ka qenë i mjaftueshëm në këtë drejtim e për këtë janë orjentuar mjetet e parapara, por nuk dihet se sa do të jetë vlera e tregut për këtë çështje, që besoj se, ne përfaqësuesit e fshatit dhe Komuna, do të gjejmë gjuhën e përbashkët për këtë çështje.

z.Nexhat Isufi- Para se të flas për planifikimin e buxhetin për vitin e ardhshëm, do të ndërlihem me diskutimin e z.Rexhep K., pasi se problemin e njejt e kemi pasur edhe vitin e kaluar. Kur u bë ndarja e buxhetit, atëherë, unë e inicova edhe atë se buxheti është ndarë 50 : 50% për të dy komunitetet, pasi se u tregua nevoja, për mjete shtesë për komunitetin shumicë, e që unë e përkraha. E tani buxheti është i këtill, siç është, e duhet të dijmë se ne jemi këtu për interesa të komunitetit. Ne, sot, para nesh kemi buxhetin për vitin 2019 dhe këtu kam leximin e parë dhe të dytë dhe se, si duket, po vjen në shprehje thënia popullore se "po dëshirojmë të trashim Kurbanin, një ditë para therjes"! Unë në mbledhjet, me rastin e hartimit të buxhetit, e kam dhënë një sugjerim apo propozim i cili po shof se nuk qenka marr parasysh dhe nuk gjendet në Listën e investimeve kapitale. Në bazë të bisedave me këshillin e fshatit tim, i cili ndër të parët e ka themeluar Këshillin në prezencën e zyrtarëve komunal, tani po e shof se ky buxhet ka dallime, sipas asaj se ku ka përkrahje politike pushteti e këtë po e them nga se dyshoj? Nuk dëshiroj të flas për kategoritë tjera, pos për kategorinë e investimeve kapitale e nuk do të flas për kategorinë e pagave, nga se ato shkojnë, aty ku ke kanë vendin. Si shembull, nga leximi i fundit të buxhetit, po e marr Restelicën e cila është në pikat 27, 28 dhe 29 e që, në leximin e parë, për këtë fshat ishin 150 mijë euro e tani, në leximin e dytë, janë 170 mijë euro dhe kjo është mirë, nëse është si rezultat i ndikimit të qytetarëve dhe parashtrohet pyetja se a është në pyetje ndikim qytetarë, apo ai politikë? Edhe te numri rendor 33 kemi një ndryshim prej 5 mijë eurove, te numri rendor 37-fshati Bresanë ka 150 mijë euro për asfaltim të rrugëve e që, në leximine sotëm, kemi 220 mijë euro? Pra, kemi dallimin prej 70 mijë eurove dhe se paskëm të drejtë të theksoj se qytetarët dhe votuesit nuk paskan pasur ndikim, por politika?! Unë kam dëgjuar se, vetëm në 2-3 fshatra, janë mbajtur tubime me qytetarë dhe tani te fshati Kuk – numri rendor 39 ka pasur 73 mijë euro e tani ka 83 mijë euro-pra 10 mijë euro shtesë, por nga u siguruan këto mjete dhe kush ndikoi që të jetë kështu?! Te numri 36, prap, figuron i njejt dhe athua është bërë qëllimisht, apo, vitin tjetër, nuk do të investohet në këtë fshat? Po apostrofoj se, kur po fillojnë punimet te ne, po bëhen në kohën kur janë prezent kurbetçarët dhe se janë prezent tollovit me dasma e manifestime tjera e ne, atëherë, po bëjmë rrënimë e po ndërtojmë ujësjellës e kanalizime?! Kjo nuk shkon kështu, por të punohet, siç duhet, dhe mos të parashihen mjete të pëgjysmuara të projekteve, por të përfundojnë në tërësi projektet..., duke u marr parasysh mendimi i qytetarëve. Edhe një herë, po e përmendi fshatin Blaç dhe atë se ne kemi numër të madh studenësh e që sot janë ekonomistë, inxhinierë etj.49 magjistra të diplomuar e ata presin e që ne, bashk me ata, t'i mbikçyrim projektet e jo vetëm Komuna? Ta dini se, nëse këto kuadra nuk janë në organe mbikëqyrëse të punimeve, do të keni reagime të qytetarëve. Mua më vjen mirë që tash më kanë reaguar banorët e fshatit Bellobrad për këto çështje reth stadiumit të ndërtuar atje, dhe se punëkryesi nuk e ka marr shumën e mjeteve, sipas tenderit. Ne të gjithë e dijmë mirë se si kryhen punimet nga punëkryesit dhe kemi shkuar në kontroll të një projekti pas përfundimit të tij e po theksoj se te ajo rrugë nuk mund të kalohet me automjete dhe vlen të shiqohet vetëm stadiumi i qytetit ku, disa herë, kemi investuar nga 70-80 mijë euro dhe mosni më kështu se kjo është çështje kriminale?! Unë nuk e di se si, ai person i cili ka pranuar punimet, mund të thotë se ato janë pranuar dhe s'di se mund të flen natën dhe si mund t'a quan veten inxhinier e profesionist?! Punëkryes të tillë duhet të

janë në "listën e zezë" dhe të dënohen, siç parashihet me ligje. Tani dëshirojmë të investojmë 80 mijë euro në fshatin Blaç dhe, ato mos t'i mbikëqyrim, kjo kështu nuk shkon, nga se në ato stadione luajnë fëmijët tonë e unë fëmiut tim ia kam ndaluar luajtjen atje, sepse nuk jam në gjendje t'i paguaj shërbime për otropedi?! Unë, për këtë jam nëgjendje të ju dërgoj atje me veturën time, për t'u bindur se nuk ka asgjë që mund të pranohet e, nëse ju e votoni pastaj, unë do të jam me ju?! Te pika 6 parashihet, në arsim, rregullimi i banjove të shkollës në Blaç, që unë mendoj se në mandatin tim, që 2 herë, po ndahen mjete për të njejtin qëllim. Ju lutem, të kemi njëherë një projekt siç duhet e kjo është puna jonë, ndërsa ata që punojnë të punojnë, siç duhet, e qytetarët të janë të kënaqur.

z. Rexhep Kamberi- I Nderurai z. Nexhat I., kritika ime ishte pa qëllim, që të respektohet ligji, pasi se vijmë në stuata që MAPL-ja po na i këthen vendime tona për rishqyrtim e kjo që theksova qëndron në ligj e unë nuk, dyshova në qëllimet e mira të pushtetit lokal, që kërkova minimumin që i takon komunitetit jo shumicë. Megjithatë, unë theksova se ne, parimisht, do të votojmë, por që i propozojmë kryetarit dhe pushtetit lokal, që në bashkëpunim me Drejtorati e Urbanizimit dhe ZLKKthimit, të bëjnë korigjime, që të vjen në shprehje shpërndarja reciproke. Unë do t'i kisha dhënë edhe një sugjerim zotëriut kryetar që, në të ardhmen, me rastin e shqyrtimit të buxhetit, që mos të dëgjohen vetëm përfaqësues të partive, por që diskutimet të janë gjithpërfshirëse, që të bisedohet me delegatët e të gjitha subjekteve politike dhe përfaqësues të fshatrave, pasi se nuk bënë që dikush që nuk ka kurrfar pozite në fshat e që, me disa nënshkrime, të vjen e të paraqes kërkesa për asfaltim të rrugës së vetë?! Për këto gjëra duhet të njoftohemi ne delegatët dhe nuk bënë që, vetëm një parti politike, të harton buxhetin?! Pra, në hartimin e buxhetin duhet të përfaqësohemi të gjithë, si dhe ZLKKthimit e ky është sugjerimi i im, për të eliminuar paknaqësitë dhe dilemat reth buxhetit.

z. Nexhat Isufi- z. Kamberi, ju keni të drejtë, por unë kam edhe më shumë. Për komunitetin gorano-boshnjak janë ndar 830 mijë euro, mjetet e përbashkëta 400 mijë euro dhe për komunitetin shumicë 839 mijë euro, apo 9 mijë euro më shumë, e vetëm këtë desha ta keni parasysht.

z. Velid Haxhisin- Hartimi i buxhetit është proces paksa më i gjatë, që fillon qysh në Pranaverë dhe jami kënaqur me ecuritë e tij, pasi se kemi pasur disa takime lidhur me buxhetin e pastaj leximin e parë e pastaj edhe diskutimet publike, por, që mjerisht, kishte nga 5-6 veta dhe 3 delegatë të Kuvendit. Këtë po e theksoj për të pasur parasysht se sa jemi serioz si Kuvend dhe se sa po marrim pjesë në hartimin e buxhetit e pastaj po ankohe mi kur ai po miratohet, definitivisht. Shpresoj që drejtorët të kenë dhënë kontributin e tyre në në Bordin e Drejtorëve dhe se kryetari i ka marr parasysht propozimet e tyre, pasi se mund të ngjan që kryetari i ka anashkaluar propozimet e tyre e mjetet që nevoiten realisht të kërkohen nga pozicionet tjera. Ne i kemi miratura planet e tyre të punës dhe, në bazë të tyre, të vjen në shprehje shpërndarja e buxhetit, për punë efikase. Ndërkaq, sa u përket shpërndarjes së mjeteve për shumicën dhe jo shumicën, mendoj se shënimert janë pak sa paushale dhe unë dje, në Kkomunitete, u angazhova, e kjo mund të vërtohet, se nga Granti i përgjithshëm 99 mijë euro janë paraparë për rajonin e Opojës e 640 mijë euro për atë të Gorës e kjo me përqindje është 61 : 39% apo

65 mijë euro. Edhe te Granti i arsimit kemi dallimin prej 2% apo 4 mijë euro, apo në tërësi 70 mijë euro në favor të komunitetit shumicë, dhe e dijmë se komunat, ku jetojnë komunitetet jo shumicë, përfitojnë buxhete shtesë, pikrërisht për komunitetin jo shumicë. Nëse kjo komuna e jonë do të ishte një nacionale, do të merrte më pak mjete buxhetore. Pra, sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësiive, ne si Komunë, përfuqtojmë në ermër të komunitetit jo shumicë-mjete shtesë, kështu që nuk do të ishte mirë që të krijohet rregull që, komunitetit jo shumicë, t'i mohohet e drejta për disa mjete. Ate që e theksoi z.Nexhat I. ajo qëndron dhe ka qenë prezente viteve të fundit dhe kemi pasur njëfar "diskriminimi pozitiv" e që ka qenë i favorizuar komuniteti jo shumicë. Kemi propozimin që kryetari e theksoi në fillim se, nga ato 70 mijë euro, 50 mijë t'i rikthehen komunitetit jo shumicë, duke pasur parasysh projektet e pa përfunduara, siç janë: Pozicioni nr.7 vazhdimi i kanalizimit në fshatin rapçë me plus 5 mijë euro, ndërtimi i murit mbrojtës në Mlik me 15 mijë euro dhe 5 mijë të tjera, pastaj pozicioni i ndriçimit publik me 5 mijë euro dhe 35 mijë të tjera për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Restelicë, pasi seç e dini ka qenë në pyetje projekti shumvjeçar? Unë pajtohem me parafolësit, por duhet ditur se ne kemi humbur edhe 60 mijë euro për mjetet e parapara në ndërtimin e Qendrës së Komuniteteve në fshatin më të madh-në Restelicë që nga viti 2011, pasi se në pyetje ka qenë një Vendim gjyqësor si pasojë e gjyqëtarëve të korruptuar nga i cili konstatim ata mund të identifikohen vetë?!

z.Vehbi Nazifi- Hartimi i buxhetit është një fazë e cila duhet të kalon dhe mendoj se e kemi kryer me sukses. Me rastin e hartimit të buxhetit kemi pasur takime publike dhe konsultime të ndryshme dhe unë vetëm dëshirova të ndërlihem në diskutimet e delegatëve të komunitetit jo shumicë e situatën e nejt e kemi pasur edhe në Komuniteteve e kjo çështje është therksuar edhe nga ZLKKhimit lidhur me ndarjen jo reale të buxhetit. Mua më duket se kjo Zyrë më shumë duhet të merret me integrimin e komuniteteve e jo me shpërndarjen e buxhetit dhe mendoj se nuk duhet të bëjmë ndasi në mestë komuniteteve shumicë apo jo shumicë, pasi se ne jemi një tërësi dhe se, në bazë të kërkesave, do të shkojnë investimet. Ju e dini mirë se, në pjesën e Opojës, ngecim me investime në peridhën e fundit 10-vjeçare e që ajo pjesë, ndoshta, ka më shumë nevojë për investime, që i kisha lutur, delegatët e komunitetit jo shumicë, të janë më serioz reth kësaj çështjeje. Në vitet mëhershme kemi pasur situata se ka pasur më shumë investime në komunitetin jo shumicë dhe mendoj se tani nuk duhet të merremi me çështje të tilla e më mirë do të ishte të merremi me cilësin e projekteve e jo me atë se ku dhe sa investohet. Po ashtu, edhe sa u përket shumave të mëdha në lokalitete të caktuara, është normale se kërkohen më shumë investime, nga se edhe më shumë pagujën obligimet qytetare, siç është tatimi në pronë e këtu e marr si shembull Restelicën e cila ka më shumë banorë dhe, është normale, që atje edhe më shumë të investohet, si dhe atë se nuk mund të krahasohet fshati i vogël me fshatin më të madh.

z.Zaim Hajredini- Është bërë traditë që para votimit të buxhetit të dilet me propozime të reja e, nganjëherë, bëhen edhe propozime "ad hock" e pastaj të tërhiqemi nga propozimet e tilla. Siç tha edhe kryetari, ky buxhet nuk mund të jetë më i miri për të gjithë dhe ne si delegat duhet të kuptojmë se sa

është e vështirë të hartohet buxheti e sidomos kur komuniteti nuk është hartues i tij. Për lëshime në hartimin e buxhetit, edhe ne delegatë jemi fajtor, pasi se nuk kemi qenë aktiv sa duhet nëpër debate kushtuar buxhetit dhe tani po dalim me propozime të reja, duke kërkuar korigjime, nga një projekt në tjetrin. Sa u përket kolegëve, nga komuniteti jo shumicë, po theksoj se asnjëherë nuk kemi pasur qëllimin tendencioz të shpërndarjes së buxhetit, por që me rastin e shpërndarjes së buxhetit, edhe nëpër familje, nuk mund të ketë harmoni strikte e lere më nëpër fshatra. Për këtë, nuk mendoj se ka diskriminim tendencioz në shpërndarjen e buxhetit tek komuniteti jo shumicë. Këtë e dëshmon edhe oferta e fundit lidhur me rregullimin e stadiumit të qytetit në Dragash e, në ndërkohë, del propozimi për një shumë prej 50 apo 60 mijë eurove e cila duhet të riorjentohej tek komuniteti jo shumicë e që, ndoshta, ka ndikuar në disproporcionin e buxhetit e që kjo nuk ka qenë me ndonjë qëllim e që nuk ia vlen të futemi në debate, kurse, stadiumi, do të shfrytëzohej si objekt i përbashkët për komunitetet tona, pasi se, siç theksoi edhe z.Nexhat I. kemi klube futbolistike që mezi mbijetojnë e në atë stadium qyteti do të ushtronin bashakrisht. Për, ky është vetëm një propozim dhe nuk do të ndryshohet asgjë në bilancin e mjeteve që do të jetë i njëjt, pasi se, nëse fillojmë me ndryshime, do të bëheshin ndryshime të mëdha të cilat do të krijonin probleme. Sa i përket sanimit të banjove në shkollën ku unë punoj-Blaç, kjo është e katërta apo e pesta herë që po bëhet rinovimi i tyre dhe gjendja prap është e vështirë atje. Lidhur me këtë, unë mendoj se duhet të bëhet aneksi të objektit, sepse rinovimi nuk do të sjell asgjë të re në përmirësimin e gjendjes në to, pasi se janë të ndërtuara në vitet e 60-ta e për këtë anagzohem që të bëhet aneksi në atë shkollë?

z.Rexhep Kamberi- z.Zaim H. unë fare nuk dyshoj se qëllimi i kryetarit dhe i ekzekutivit ka qenë tendencioz, por që tjesht e konsideroj gabim të cilin duhet përmirësuar. Sugjerimi im, që vendimet e miratuar të harmonizohen me ligjet, janë që mos të kemi vërejtje nga MAPL-ja apo organizatat ndërkombëtare. Prandaj, nëse mund të bëhen përmirësime, të bëhen tani. Po theksoj edhe këtë, pasi se jam në foltore, e të përfshihet në Procesverbal, po theksoj pikën 12 kam thënë se duhet të qëndron ndërtimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit dhe meremetimi i atij të vjetrit në fshatin Gllaboçicë, që pra këtu të bëhet korigjimi e gjërat tjera ngelin njëjtë. Ndërkaq, te kubëzimet, mjetet e pikës 11 të zvogëlohen në llogari të pikës 12, ku nevoiten më shumë mjete.

z.Nexhat Isufi- z.Zaim H. mirë përmendi atë se dikush nga drejtorët ka ndryshuar një çështje dhe të jetë e qartë e të merremi vesh se sot bisedohet për buxhetin, por që nuk mund t'a ndryshojmë siç dëshirojmë dhe atë nuk e ndryshojnë drejtorët apo dikush tjetër dhe, nëse ne jemi ata që ndryshojnë buxhetin, pse pra mos të ndryshohet pozicioni në fshatin Blaç? Unë, në pushtetin ekzekutiv nuk kam ndonjë drejtor, apo zyrtar, dhe gjërat janë të qarta se, ne delegatët, duhet të bëjmë shpërndarjen e buxhetit e sa do të jemi të sukseshëm kjo është çështje tjetër.

z.Zaim Hajredini- Unë nuk thash se drejtori e ka ndryshuar buxhetin, por ka bërë mirë që ka propozuar dhe mirë që është bërë ndryshim për fshatin Blaç, pasi se kjo është kërkesë e fshatit dhe shkollës.

z.Samidin Xheladini- Ky është buxhet dhe duhet të ketë perspektivën për zhvillim ekonomik në nivel afatgjatë, duke përfshir në veditë projekte dhe propozime për ndërtim të infrastrukturës moderne. Mundësia e hapjes së vendeve të punës, zhvillimi i turizmit, energjetikës, bujqësisë, krijimit të zonave të reja industriale me projekte konkrete ku do të dominonin për ndërtimin e rrjetit të ujsjellësëve, kanalizimeve, kolektorëve për ujërat e ndotur, ndërtimi kanaleve dhe kablllove të posaçme për rrjete elektrike të cilët do të ishin se rezultat për siguri të qytetarëve dhe mos ndërprerjen e energjisë elektrike bazuar në specifikat e komunës sonë. Në këtë mënyrë, do të krijohet baza moderne e afatgjate për zhvillim e kjo duhet të ndodh, hap pas hapi, në secilin fshat e jo, si deri tani, të punohet 2-3 herë në të njëjtin investim dhe të përsëriten punimet e që do të na kushtonin më shtjetë, duke u përsëritur investimet. Këtu i kam për bazë fshatrat tona lidhur me rrjetin e kanalizimeve që janë ndërtuar e tani po krijohet nevoja me probleme reth sigurimit të ujit të pijes. Konkretisht, mund të them se në të gjitha rrjetet e ujsjellësëve, ku kemi investuar, mungojnë ventilat siguroes që rregullojnë presionin e ujit, mungojnë hidrantet në raste të paraqitjes së zjarreve etj. Pë këtë, pres seriozitet të pushtetit lokal, duke pasur parasysh se jemi në shpandarjen e buxhetit në shumë prej më shumë se 2 milionë euro, mjete këto të cilat nuk duhet të na shkojnë në suficit. Neni 11 i Ligjit thekson se "hargjimi i mjeteve për paga, mallëra e shërbime, subvencione dhe investime kapitale do të realizohet në harmoni me rregullat, procedurat dhe standardet për shfrytëzimin e mjeteve publike". Më duhet të theksoj se, me iniciativën time të shpesht, është shtuar shuma e subvencioneve, për shkak të nevojave të shtuara për përkrahje materiale dhe dëshiroj të parashtoj pyetje se a keni Plan konkret se si do të bëhet subvencionimi i qytetarëve. Në nenin 14 theksohet se buxheti ka filluar në tetor me propozimet e subjekteve publike, Bordit etj. Ne në terren kemi probleme lidhur me themelimin e këshillave të fshatrave, nga se, shumë fshatra, nuk janë të përfaqësuar në Kuvend-me delegat dhe se janë marr parasysh kërkesat e qytetarëve. Kërkoj që, mjetet mos të na këthehen, në suficit dhe se projektet të cilët do të realizohen të realizohen në mënyrën më të mirë të mundëshme. Disa fshatra janë përfshi me kubëzime, siç është fshati Xerrxe e taje kemi nevojë të investimit edhe në shkollë dhe të shifet se ku ka më së shumti nevojë, për investime.

z.Sefidin Mejzini- Nëse kjo pjesa-Gora nuk qenka e kënaqur, unë duhet t'a lëshoj seancën, pasi se nuk kam par asnjë fshat të Gorës me nën 15 mijë euro?! Fshati im (Kosava) është 3-4 më i madh se disa fshatra, e janë paraparë nga 10 mijë euro, e madje në leximin e parë nuk janë paraparë fare mjete?! Pra, të jemi racional se, "nëse jepet dora, kërkohet edhe krahu"?! Ky, absolutisht, është "buxhet politikë"?! Ne, komuniteti i fshatit Kosavë, në tërësi, jemi të diskriminuar dhe kur dihet se fshati ynë numron 1300 banorë, 4 lagje dhe vetëm 10 mijë euro, kurse, në fshatrat shumë më të vogëla, janë ndarë nga 30-40 mijë euro, kjo është e pa pranueshme. Unë jam i zgjidhur që të përfaqësoj komunitetet dhe të drejtat e tyre dhe vetëm votuesit e mijë, por edhe tuajtë nga fshati Kosavë, e nuk do të më lejojnë të votoj këtë buxhet? Kërkoj që të keni mirëkuptim, edhe për votat tuaja nga fshati im, ku keni marr 5 herë më shumë vota, se sa sa në ndonjë fshat tjetër?! Fshati ynë është specifik, si kanton, secila lagje ka infrastrukturë të ndarë dhe, nëse i ndajmë 10 mijë euro, në 4 lagje, ka aq mjeta sa për një kafe makiato?! Ju, qe 10 vjet që jeni në pushtet, janë investuar 0 mjete në shkollën e fshatit

dhe ka pasur raste se, mjetet e parapara për këtë shkollë, janë orjentuar në shkollë tjetër? Mjetet që arrijnë nga niveli qendror nuk vijnë të "ngjyrosura politikisht", por sipas kokës së banorëve. Më 2016, për fshatin Kosavë, janë ndarë 30 mijë euro nga të cilat, asnjë cent, nuk është shfrytëzuar për këtë fshat?! Më 2017, për rrugët e parapara në fshat, 3 dita para zgjedhjeve, materiali komplet është është dërguar në Gorë dhe, ata, po kanë të drejtën për t'u ankuar, nga se u është dhënë mundësia! Rruga për të cilët flas është përplot me familjarë të mijë dhe ka ngel ashtu dhe nuk di, nëse është filluar rruga më 2017, e të ketë ngel ashtu pa përfunduar e kjo ngau vetëm në Kosavë?! Kërkoj nga kryetari të na trajton të barabartë, nga se të gjithë ecin nëpër kubëza e shkolla jonë është ndër shkollat që nuk ka përfituar kurrfar investime. Ata nxënësit nuk janë fajtor që unë jam i partisë politike-LDK, por e meritojnë të kanë kusht, et siç i kanë të gjithë nxënësit tjerë.

z.Zinaida Elmazi- Unë, dje në mbledhjen e KPFinanca, u deklarova se nuk jam e kënaqur me shpërndarjen e buxhetit të paraparë, pasi se ai është 64% i disfavorshëm për komunitetin jo shumicë. Këtu po shifet se prioritet po kanë fshatrat më të mëdha dhe e kuptoj se kanë nevoja, por nuk e kam të qartë se si po kopjohen listat dhe po përsëriten të njejtat projekte dhe s'di se me kend po bashkëpunohet, kur janë në pyetje prioritetet e fshatrave?! Nuk është reale ndaj fshatrave më të vogëla që, gjithmonë të përfitojnë më pak mjete dhe kurr nuk po mund të realizojnë projekte në tërësi, por në faza dhe, pastaj, po kemi probleme me cilësinë e punimeve, pasi se projektet po punohen në vazhdimë. Nga fshati Kukajan ka Kërkesë dhe e kanë prioritet ndërtimin e rrugës në drejtim të "Fuçjamës", nga se lidh shumë fshatra e këtu qëndron kubëzimi dhe 15 mijë euro janë të mangët, a për projektin e tillë e këtë e theksova që kryetari dhe ekzekutivi këtë t'a kenë parasysh në vitin tjetër, pasi se është rrugë me interes për të gjithë ne. Nën pikën 32-kubëzimi i rrugëve dhe infrastruktura përcjellëse në fshatin Lybevisht, këtu duhet të qëndron "Gumena", pasi se kjo është lagje dhe, çdo vit, qytetarët e kësaj lagje parashirojnë kërkesa të cilat nuk dihet se ku përfundojnë e, në anën tjetër, në fshatin Lybevisht, projektet realizohen për çështje tjera?

z.Hajrudin Hoxha- Edhe sot kur po e debatojmë buxhetin, është vit i pestë që diçka nuk po pajtohet dhe, që është më e keqja, duhet filluar nga fundi. Pajtohem, plotësisht, me diskutantët dhe unë do të fioli për shëndetësinë dhe përkujdesjen sociale e, ndoshta, është prezent edhe drejtori i DSH-së, ndërsa ne në Restelicë, që 5 vite, po presim për rinovimin e ujësjellësit. Kemi një kategori, te blerja e automjeteve për DSH-së, dhe vetë drejtori ka pyetur se për çfarë automjeti është fjala? Përgjigja është dhënë se është për Drejtoratin, por çka është me Restelicën, si fshat më i madh dhe mi largët e që pacinetët po na vdesin deri të mbërrijnë në Krushevë apo Dragash, e drejtori do të vozitet me veturë 25 mijë euro?! Unë do të jap propozimin që makina tillë, të jetë makinë ambulante, për fshatin më të madh të Komunës-Restelicën. Ne jemi delegatët ata të cilët ndryshojnë destinacionin e mjeteve buxhetore. Edhe furnizimi me mjete shëndetësore brengos, nga se të gjithë jemi dëshmitarë se pacientët, që paraqiten te mjeku, me reçeta në dorë, ua mësyjnë barnatoreve private, nga se ambulancat nuk kanë barna themelor. Kjo, ndoshta, është pak ma lehtë për të punësuarit, por çka me të papunët dhe, më vjen mirë, që me buxhet është paraparë shuma prej 64 mijë eurove, për këtë

qëllim e, ndoshta, do të zbutet gjendja?. Te kultura e sporti po theksoj se ato janë veçori e një popullate dhe e civilizimit, por sa i përket pjesës së Gorës propozimet janë më shumë politike se sa reale? Ajo që më brengos është ndërtimi i stadiumit shkollor në Brod, kurse në fshatin Restelicë stadiumi shfrytëzohet si depo e materialit ndërtimor dhe unë isha përdje atje dhe vëreja se nxënësit po luajnë në atë stadiun nën pirunin e eskavatorit dhe për këtë propozoj, që mjetet e parapara për stadiumin në Brod, të orjentohej për në Restelicë. Këto nuk janë mjetet të investimeve kapitale, , por po theksoj se në Krushevë ekziston një park, që mendoj se ka qenë donacion i KFOR-it turk, dhe çka do të jetë tani rregullimi shtesë, nuk e di, pasi se fëmijët tjerë nuk kanë fare park?! Pra, mendoj se është e pa nevojshme shuma prej 10 mijë eurove, për këtë park, sepse, nëse nuk i planifikojmë mirë mjetet, ato po na shkojnë në suficit! Sa u përket planeve investuese, unë nuk e di kush është autori-ZLKKthimit apo ndonjë parti politike, e këtë e kam kërkuar edhe më herët? Sa i përket Restelicës, ne po kërcejmë nga një kodër të tjetrën, pasi se ndërtimi i ujësjellësit famoz po shtyhet që 4 vite, për çka Komuna e filloi projektin e pastaj banorët grumbulluan mjete në shumë prej 25 mijë eurove dhe ai përfundoi. Këtë vit po ndërtohet bazeni i ujit, pasi se që 20 vite nuk është furnizuar me ujë dhe ishte si lapidar dhe askush nuk ndërmorri masa?! Tani aty e kemi ujin, por kam dëgjuar se ekziston edhe një kërkesë edhe për 30 mijë euro për vazhdim të projektit e këtë e kam dëgjuar nga z.Velid H. Ju e dini edhe rastin se, në Pranverë, në Restelicë ka qenë një gjendje emergjente, për të cilën ka pasur kërkesa nga banorët e fermerët për sanimin e rrugës e nuk dihet se çka u ndërmorr e unë, vazhdimisht, kam kërkuar mjetet për mbrojtje nga rrëshqitja e rrugëve? Në atë rrugë rrëshqitëse nuk kalojnë vetëm banorët e Restelicë, por edhe tjerë nga mbar Kosova dhe, fatkeqësia, mund t'i ndosh çdo kujt. Për ato 80 mijë euro për ndërtimin e QKomuniteteve, mos llogaritni, nga se ajo ndërtesë famoze mund të shëndërrohet në ndërtesë të urrejtjes te ne, e për shembull të tillë, e kemi rastin e njejtë të Krushevës me të cilin po qeveris "Vakat"-i?! Ajo ndërtesë, e paraparë në Restelicë, ende është kontest dhe mjetet do të shkojnë në suficit?! Ndërkaq, Restelica ka nevoja tjera dhe propozoj që, 50 mijë euro nga ajo QKomuniteteve, të orjentohej për vendosjen e kubëzave aty ku ka nevojë, pasi se janë paraparë vetëm 20 mijë euro për kubëzime te ne. Në mbledhjen e kaluar është propozuar asfaltimi i rrugës Krushevë-Zlipotok e që nuk ka filluar e janë propozuar 50 mijë euro investime e duhet menduar për rrëshqitje të dheut në rrugën për Krushevë, pasi se ajo pjesë lidh disa fshatra e mos të llogaritet se vlen vetëm për Krushevën e që janë paraparë 50 mijë euro, kurse është diçka tjetër që parashihet për infrastrukturën e këtij fshati? Lidhur me ndërtimin e parkut të fëmijëve në Brod, atë projekt dikush po e favorizon politikisht? Mjerisht, Radesha ka vetëm një kubëzim e projektet e propozuar nuk janë realizuar. Rapça është kompletuar e ka ngel vetëm ndriçimi i rrugëve, apo, ndoshta, do të kërkojnë që t'u paguhet edhe rryma?! Nuk jam kundër, por kur të përfundon ndriçimi në fshatrat tjera të Gorës e Opojës, të përfundon ndriçimi edhe në Rapçë. Në njerën nga seancat e mëparshme pata theksuar se "disa janë të smurë nga trashja e disa vuajnë nga uria" e që isha i kritikuar për këtë, pasi se disa fshatra po kompeletohen e disa nuk janë kërkuar. Pra, angazhohem për korigjimin e projekteve në Krushevë e Restelicë, që të përfundojnë projektet e parapara më herët e pastaj të mendohet për të tjerët?

z.Velid Haxhisin- Sa i përket QKomiteteve në Restelicë, po theksoj se skena politike është qudtishme dhe janë të mundëshme ndryshimet dhe, ndoshta, edhe partia e tij politike (JGP) ndonjëherë do të fiton pushtetin dhe se nuk do të mund të hyhet në zyrë nga ju. Unë theksoj se ajo zyrë do të shfrytëzohet për nevojat e qytetarëve të Restelicës e jo për parti politike e për te kontesti është që 7 vite dhe do të përmendi një barcoletë: "Një njeri është nisur për në pyll dhe miku e këshillon që mos të shkon se do t'a hanë ariu e ai ia këthen se do të hip në dru, por ai ia këthen se edhe ari hip në dru e ai ja këthen se për cilin simpatizon ti-për mua apo për ariun"?!

z.Hajrudin Hoxha- Unë i nderuar, nuk simpatizoj as për ty as për ariun, por e simpatizoj popullin. E kemi shkruar "Mirë se erdhe diasporë", por në baltë, pa ujë, pa kanlizime, pa rrugë. Unë qarkulloj nëpër fshat dhe i di nevojat e qytetarëve dhe unë nuk e kam një rrugë, pasi se e kam komplet Restelicën dhe për këtë jam kundër kësaj Qendre, kurse nga z.Selman O.dëgjuam se në Krushevë ajo Qendër është ndërtuar dhe nuk mund të hyhet aty?! Dhe, për këtë, "unë nuk simpatizoj as për ariun e as për ty" ?!

z.Refik Latifi- Kjo pikë që po e shqyrtojmë është e rëndësie të posaçme, pasi se miratojm buxhetine vitit 2019, kështu që qasja në shpërndarjen e buxhetit duhet të jetë shumë më serioze, pasi se shfrytëzuas më të mëdhenjë të tij janë qytetarët, nëse shpërndahet ashtu siç duhet. Por, ky buxhet nuk garanton zhvillim produktiv ekonomik, pasi se shumica e investimeve kapitale janë paraparë për kubëzime dhe janë dhe janë lënë anash lëmi të rëndësishme që do të ndikonin në zhvillim ekonomik të Komunës. Në lëmin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe turizmit shumë pak është investuar, kështu që kërkoj të investohet edhe në këtë kategori buxhetore. Shfrytëzues më të mëdhenjë të buxhetit janë qytetarët dhe unë do të jap disa propozime dhe krahasime, me planin e paraparë, për këtë periudhë buxhetore. Vërehet se kemi shtim dhe zvogëlim të investimeve, për disa lokalitete, dhe kërkoj të dihet se në cilat baza janë bërë këto shtime dhe zvogëlime buxhetore? Pra, a janë bërë këto në bazë të takimeve me qytetarë, me preferenca politike, apo...? Këtu desha të jap një paralele, sepse psh.është planifikuar ndërtimi i stadiumit dhe infrastruktura përcjellëse në Dragash e tani kjo mungon nga Lista? Propozoj që mjetet e parapara për të njejtën kategori, të pëcillen diku tjetër. Po ashtu, vërehet se, në fshatrat e vogëla, ka më pak investime si fshati Xerrxe me vetëm 15 mijë euro-për kubëzime dhe do të ishte mirë që me buxhet të parashihet rinovimi i shkollës?

z.Naser Myrtezani- Edhe unë, si delegat, i kam vërejtjet e mia lidhur me investimet që do të kryhen vitin e ardhshëm. Unë, si delegat, dhe parti politike(LDK), kam vërtje në lokalite të caktuara e rasti konkret është në fshatin Zaplluxhe, që unë një pyetje të tillë e kam parashtruar në seancën e kaluar. Pra, fshati Zaplluxhe është i diskriminuar në kuadër të projekteve të Komunës, pasi se ka paraparë projektin për rrugën e "Gurit të Zi" e ajo nuk i përket Zaplluxhes, por është "Parku Nacional" dhe si e till duhet llogaritur. Faktikisht, me këtë projekt, fshati Zaplluxhe përfiton vetëm 10 mijë euro, për kubëzim. Sipas kësaj gjedjeje, realisht, fshati Zaplluxhe nuk po përfiton asgjë, madje as shkolla?! Prej kur se është ndërtuar kjo shkollë, praktikisht, nuk ka përfituar asgjë nga investimet, pos

intevenimeve të vogëla që kanë ngjarë, në ndërkohë, pos tabelës dhe shkurtyshave dhe ekzistimit të nxënësëve, asgjë nuk është investuar?! Investimet kanë qenë, kryesisht, në vendosjen e kubëzave dhe investimet, që keni paraparë, në tërësi, janë diku 490 mijë euro për kubëzime. Nga momenti kur keni ardhur në pushtet, kryesisht, jeni koncentruar në vendosjen e kubëzave që unë dyshoj se këtë e keni bërë qëllimisht dhe atë në ato rrugë ku janë votuesit tuaj?! Në rastin konkret, për këtë, është fshati Zaplluxhe ku i keni vendosur kubëzat në qendër ku këthen autobusët e ne, nga ky fshat, madje kemi dhënë mjete me vetëkontribut për të kubëzuar rrugë të caktuara e ju i keni vendosur atje ku i keni militantët tuaj partiak, duku u shtuar edhe oborret?! Lidhur me këtë, i kemi edhe emrat e mbiemërat dhe kemi argumente. Të shumë të tjerë u është thënë që të heqin dyert hyrëse të oborrit, sepse do t'u kubëzojmë edhe oborret! Kjo nuk është reale, pasi se të gjithë jemi obligues tatimor që paguajmë e kjo kështu ka ngjarë edhe në fshatin Blaç. Kemi rastin ku, në këtë fshat jua shtruar me qindëra metër, vetëm e vetëm, pse aty është shtëpia e një militanti partiak në pushtet! Ndërkaq, në anën tjetër, kemi rrugë me 4-familje e në ato nuk janë vendosur kubëza, nga arsyeja se janë votues të partisë tjetër?! Kështu, në fshatin Bresanë, kemi familjen Ahmeti e cila nuk e ka përkrahur partinë politike në pushtet e rruga e tyre ka ngel pa kubëza, sikurse është edhe familja Qazim?! Unë, mbetem të shpresoj se kryetari i tashëm i Komunës do t'a shfajtojë të arsyeshme që të ndryshon mentalitetin e deritashëm dhe se, më shumë, do të investohet në shkollë, pasi se janë institucione që luajnë rolin më të rëndësishëm në shoqërinë tonë. Në shkollë dihet se kohën e kalojnë më të shumtë tonë-fëmijët të cilët vijojnë mësimet, ndërsa shkollë në të cilën punojnë 15 vite nuk është investuar asnjë cent, kurse kulmi i saj pikon dhe ka nevojë për pllakë dhe kulm të ri. Shkollë më e madhe e Opojës-në Bresanë, nuk ka as kompjutera apo paisje tjetër, pos dy kompjuterëve prej të cilëve një është te drejtori dhe një tjetër-të vjetër. Prandaj, duhet të bëni gjithçka që të investohet nëpër shkollë, pasi se në këto shkollë nuk kemi as kabinete për kimi, apo fizikë e biologji. Ndërkaq, shkollë në Blaç ka nevojë për rrethojë, pasi se është ajo e viteve të 80-ta e atje ka rrezik për fëmijët tonë. Shkollë në Rrencë është me gjendje të njejtë, sikurse që është në gjendje jo të mirë edhe ajo në Kosovë. Sa i përket shkollës së Kosovës, atje kemi edhe probleme pronësoresh-juridike që duhet t'i zgjidh Komuna, drejtori i shkollës, qytetarët dhe drejto i DKA-së dhe ju z.kryetar i cili jeni përgjegjës për këtë. Kam edhe një pyetje lidhur me librat shkollorë, pasi se këtu është drejtori i DKA-së e në shkollat tona ende nuk kemi librat e "Dukagjinit", 40% të mjeteve shkollorë na mungojnë e jemi në fund të muajit shtator e na mungojnë librat shkollorë. Për Plaljnikut kemi dëgjaur se janë mbajtur disa mbledhje me ish-kryetarin e Komunës i cili u ka dhënë shumë premtime e nuk ka kryer asnjë punë? E vetmja zgjidhje që u mbetet është të vijë dhe të mbajnë një takim zyrtar me kryetarin aktual të Komunës, nga arsyeja se njerëzve nga ky fshat nuk po u jepen subvencione nga MBujqësisë, pasi se nuk paskan zonë kadastrale?! Për këtë do të kërkoja që çështja e këtij fshati të zgjidhet, pasi se partia në pushtet ka njerëzit e vetë në pushtetin qendror, sepse, në të kundërtën, ata nuk kanë kurrfarë zgjidhje, pos që të braktisin fshatin, kurse në fshatin Xerrxe ka nevojë të rinovohet shkollë.

z.Shpetim Hajredini- Sa i përket diskutimit reth buxhetit, ne kemi pasur në shqyrtim në muajin shtator, e tani jemi në fund të muajit, kur është momenti i fundit për miratim të tij. Për mua, nuk janë

në rregull çështjet e shpërndarjes së buxhetit sipas lokaliteteve dhe, natyrisht, çdo njeri ka prioritet për fshtin e vetë dhe tenton të përfiton sa më shumë mjete, për fshtin që e përfaqëson. Kështu kemi rastin e përfaqësuesit të fshtit Blaç i cili, edhe në mandatin e kaluar 4-vjeçar të Kuvendit ishte delegat (N.I.), dhe e besoj se ka përvoja lidhur em miratimin e buxhetit, se ai harohet përmes ZLFinnciar që është nga Blaçi e jo përmes drejtorit. Ndërkaq, këtu po del se drejtori i Dfinancave, i cili vjen nga Kuki, paska paraparë më shumë investime në Kuk që për vitin 2019 për Kukin janë paraparë 83 mijë euro e për Blaçin 103 mijë euro.

z.Nexhat Isufi- Unë nuk kërkoja që ndonjë fshati t'i merren apo jo mjete dhe të kuptohemi se ka dallime në parashikime, nga leximi i parë dhe ky i dyti, dhe ato ndryshime kanë ngjarë. Natyrisht, ato kanë ngjarë me ndikimin e dikujt dhe unë fshatit Kuk nuk mund t'i marr asgjë, t'i ndahen edhe 200 mijë euro, por që mjetet të jepen aty ku ka nevojë. Në material thuhet se, P/Buxhet për vitin e ardhshëm dhe bëhetë nga Zyra e Kryetarit , kurse shqyrtimi dhe miratimi bëhet nga Kuvend.

z.Samidin Xheladini- Unë në diskutimin tim isha i shkurtër, për t'u dhënë më shumë hapësirë të tjerëve, dëshiroj të jap disa sqarime? Në bazë të diskutimeve të deritashme mendoj se kyretari i Komunës dhe pushteti lokal, në masë më të madhe, duhet t'i marrin parasysh diskutimet dhe vërejtjet e delegatëve, si dhe kërkesat e qytetarëve në zgjidhjen problemeve të tyre. Këtu, në radhë të parë, duhet të fokusohemi në zgjidhjen e problemeve të ujit të pijes, kanalizimeve, impiantëve, rregullimit të rrugëve-përfshi edhe për në bjeshkë, investimet në bujqësi, krijimit të vendeve të reja të punës, suigurimit të barnave esenciale, punë dhe rend në administratë, punësim të barabarë e jo punësime politike e partiake. Me një fjalë, punësim të barabartë për të gjithë qytetarët tonë. Nëse analizohen dhe preken të gjitha ankesat e fshatrave të caktuara, del se disa fshastra janë të privilegjuiara e disa të diskriminuara? Ne, si Komunë, duhet të kemi Plan konkret për zgjidhjen e çështjes së mbeturinave dhe ruajtjes së ambientit. Po ashtu, në periudhën e ardhëshme, duhet pasur parasysh të gjeturat dhe vërejtjet e Auditorit Gjeneral, si dhe sugjerimet e Auditorit të Brendshëm. Gjithashtu, po e potencoj se kompanit punëkryese nuk po i kryejnë si duhet punimet dhe nuk po i shfrytëzojnë mjetet e parapara për investime kapitale, që mjetet e parapara mos të na shkojnë në suficit. Ato firma që nuk i realizojnë projektet si duhet, të ndëshkohen?

z.Selman Osmani- Po e shof se drejtorit, si shpejt, e lëshuan seancën e që mendoj se e kanë obligim të punojnë dhe me gëzon ajo që do të punojnë. Sa i përket buxhetit për vitin 2019, ai është vërtetë, transparent e që, ndoshta, ka ndonjë lëshim, por gjithçka nuk është e përkryer. Sa u përket projekteve të infrastrukturës, për pjesën e Gorës, z.Hajrudin H. tentoi që mjetet, në njëfar mënyre, të transferohen nëpër fshatra e që unë nuk do të pajtohesh. Duhet ditur se Brodi e Restelica janë sinonimi i Gorës, pasi se janë dy fshtrat më të mëdha, pasi se janë në rritje dhe Restelica nuk është fshat po qendër- qytet. Edhe pse unë jam nga Krusheva, por shkoj shpesh në Restelicë dhe atij fshati duhet kushtuar rëndësi e sidomos lidhur me ata kryes të punimeve të investimeve kapitale. Ujësjiellësi famoz atje po zhagitet me vite dhe do t'i kisha lutur organet kompetente reth ujësjiellësit e kanalizimit të

angazhohen. Ky buxhet është modern dhe, njëri nga kolegët theksoi se, për 5 vitet e ardhëshme, nuk do të kemi probleme në infrastrukturë. Ndërkaq, sa i përket fshatit tim-Krushevës dhe nuk do të transferoja mjete, pasi se lojërat e parku fëmijëve nevoiten dhe nuk pajtohem me ato diskutime që, disa mjete për këtë, të transferohen në fshatra tjera. Sa i përket Administeratës dhe Personelit, mua më vjen mirë që e kemi prezent drejtorin këtu e që duhet ndërmarr diçka reth Zyrës së Vendit atje, për adaptim e rinovim. Lidhur me kubëzimet nuk jam që ato të Baçkës të transferohen në Restelicë, pasi se edhe në Baçkë kemi njerëz-votues, siç kemi edhe në Dikancë e Mlik ku kërkohet me ngulm muri mbrojtës nga kolegia Zina E. Në DShëndetësisë kemi 64 mijë euro e që kisha kërkuar nga drejtori që t'i kishtohet rëndësi më e madhe laboratorit në Krushevë, që reagensat mjekësor të arrijnë atje. Vitin e kaluar kemi pasur donacionin e Qeverisë Japoneze dhe asaj Turke, por nuk po shof përparime të mëdha për këtë, pasi se nevojite trajtim më i madh mjekësor. Në njëfar mënyre, Krusheva është qendër dhe duhet të ketë trajtim adekuat, pasi se, sipas disa statistikave, kemi diku 400 të smurë nga diabeti e që për analiza mos të orjntohen pacientët në Dragash dhe kërkoj nga kryetari dhe drejtoratet që ky buxhet, me sugjerimet tona, të pranohet e, nëse ka diku nevojë, të korigjohet.

z.Zinaida Elmazi- Unë kërkoj replikë, pasi se u apstrofova gjatë diskutimit të z.Selman O. sepse, pavarësisht se cili fshat është në pyetje dhe sa banorë ka, duhet paraparë investime në to, nga se të gjithë qytetarët paguajnë tatim dhe meritojnë investime. Dhe e dyta, s'di pse disi e përmendni Mlikin me ironi e që duhet investuar edhe po të ketë 20 banorë, por që, atë fshat, ju më së shumëti e shfrytëzoni me institucionet tuaja paralele, ku jeni kryetar, e që duhet të kujdeseni për ata fëmijë?! Pra, rruga e muri mbrojtës atje janë të nevojshëm e unë intresohet për atë fshat timin si qytetare, edhe përkundër asaj se atje mbahet arsimimi paralel?!

z.Selman Osmani- E nderuara kolege, unë nuk desha t'a karakterizoj ate se ku dhe çfar mësimi mbahet dhe unë këtu e tregoj letërnjoftimin se jam qytetarë i Kosovës e ju lutem tregone ju tuajën se ku e kenë lejeqëndrimin dhe i kisha lutur kolegët që mos të më sulmojnë me ato institucione paralele, pasi se nuk dëshiroj të humbim kohë me këto gjëra, nga se jam i zgjedhur nga 13 mijë banorë e nuk ka ardhur këtu me 20 vota që të përfaqësoj dikend?! Pra, z.kolege, unë kam ardhur me 1300 vota që ishte bartës i listës dhe vetë kisha 600 vota personalisht vetëm si parti dhe bartës i listës-JGP. Pra, unë i përfaqësoj qytetarët e Gorës, pavarësisht se si ata deklarohen Boshnjakë apo Goranë dhe ju kisha kërkuar t'i leni këto gjëra, pasi se unë nuk e pyeta askend se ku punon e unë mund të punoj në Maqedoni e të përfaqësoj këtë popull e unë këtu jam person i zgjedhur e jo i nominuar?!

z.Hajrudin Hoxha- Unë nuk jam lokalist dhe i përfaqësoj qytetarët e Gorës e këto polemika të dy kolegëve mos ta përsëriten, pasi se Restelica është madje më shumë se tërë Gora dhe, momentalisht, në Restelicë jetojnë 3500 banorë apo 480 nxënës e në tërë Gorën 370 nxënës. Për këtë, fëmijë e Restelicës duhet të kenë argëtim dhe nuk jam kundër Krushevës apo Zlipotokut, Rapçës e Radeshës e fëmijët e Restelicës luajnë nën makina ndërtimore e eskavator e paleta me blloqe... Nuk

jam edhe kundër Brodit, por që mjetet të riorjentohe në Restelicëm, pasi se mendoj se në Brod stadlumi është fenomenal, krahasur me Restelicën?

z.Artan Loshaj- Unë, fillimisht, kisha kërkuar që t'i përmbahemi rendit të ditës dhe mos të dilet, nga disa herë, para foltores lidhur me një pikë të rendit të ditës. T'i japim kontributin tonë buxhetit të paraparë dhe ata që kanë vërejtje të arsyeshme këtë t'a bëjnë dhe të bashkohemi e të bëjmë buxhet sa më të mirë. I dëgjova diskutimet e delegatëve dhe reth investimeve kapitale dhe dje në KPFinanca kryetari është zotuar për përbushjen e tyre. Te pika 1, kubëzimi dhe infrastruktura tjetër në Dragash, ju e dini se Dragashi duhet të ketë buxhet të posaçëm dhe janë paguesit më të mirë të obligimeve qytetare dhe duhet të ketë investime më të mëdha e jo të ngel në kategori të tretë, krahasuar me disa lokalitete tjera. Nuk guxohet të bëhen dallime të tilla, pasi se 30 mijë euro për Dragash janë të vogëla. Ndërkaq, investimet jera që bëhen për shkolla, apo çështje tjera nuk janë investime për qytetarë të vetë Dragashit, por mbar Komunën. Herën e kaluar, kur folëm për buxhetin, folëm për shëndetësinë dhe çështjet sociale dhe kishim 20 mijë euro për blerjen e një automjeti e tani ajo shumë qenka shtuar në 25 mijë euro e pse edhe 5 mijë euro shtesë? Rinovimi i objekteve shëndetësore dhe furnizimi me ujë-50 mijë euro, mjete medicinale-64 mijë euro, që do të thotë se në tërësi janë diku 130 mijë euro, që është në rregull, por do të ishte edhe më mirë që këto mjetet të janë vetëm për shëndetësi e me to të bëjm furnizimin me barna, e unë punoj në shëndetësi, dhe mund të them dhe them se, pas orës 10 në mbrëmje, nuk punojnë barnatoret e barnat mungojnë te ne?! Po ashtu, kemi probleme me insulinën e cila, në mënyrë permante, është gjendje e keqe. Prandaj, a s' do të ishte mirë që të parashihen diku 20-30 mijë euro për furnizim me barna esenciale, si dhe kam një kërkesë për kryetarin e komunës, pasi se po flasim për shëndetësinë dhe kemi mjaft kuadro shëndetësore që kërkoj të përkrahin, sepse javën e kaluar mjeku i pediatriisë ka shkuar në pension e po tentohet nga drejtorja e QKMF-së që të caktohet atje dr.Mstan Sadiku i cili është kryesoi në Repartin e Emergjencës e që, për dijenin tuaj, atje janë 12 mijë vizita mjekësore në vit e që nevojitet t'i shtohet edhe koeficienti, nga se kemi të bëjm me fluks të madh pacientësh dhe gjenerata të vjetra të pacientëve të cilat kërkojnë njohuri profesionale e, nuk është në rregull, të bëhen lëvizje të tilla në dëm të pacientëve tanë e që Emergjencia, praktikisht, të ngel pa mjek?! Po ashtu, në kujdestari, kemi probleme edhe me mëditjet për kujdestari sipas Vendimit të MSHëndetësisë e në anën tjetër kemi kompenzimin sipas QKMF-së? Prandaj, nëse nuk sigurohen mëditje për kujdestari në Emergjencë, ai Shërbim, shkon kah mbyllja dhe për këtë duhet menduar, duke u paraparë mjetet e nevojshme, nëse jo sivjet, për vitin e ardhshëm. Po ashtu, kam një vërjetje për DAPersonelit, pasi se këtu shkuan se parashihet blerja e një automjeti-60 mijë euro e si është e mundur kjo, pasi se dijmë se janë disa automjete që janë pothuaj të reja, apo po dëshirohet sigurimi i nga një veture për secilin punëtor të Komunës, për të shkuar vetëm në Prishtinë?! Shpesh-herë, më ka ngjar që të jam dëshmitar që 4 vetura kanë shkuar për në Prishtinë, me nga një person, dhe, a keni mundësi, të ndalohet praktika e këtillë, që përmes shkuarjes në Prishtinë, të bëhen marrveshje, për shfrytëzimin e një veture? Regjistrimi i rrugës Brrut – "Trokan" me 45 mijë euro, e nuk kanë kaluar qe 3 muaj e ajo rrugë ishte asfaltuar?! Dhe, në fund, lidhur me arsimin e shkencën, rregullimi i banjove në SHM "Ruzhdi Berisha"-30 mijë euro e ne jemi në dijeni se është ndërtuar shkolla

e re e mesme dhe athua, ndonjëherë, nxënësit do të kalojnë në atë shkollë? Te ndërtimi i stadiumin në fshatin Brod-30 mijë euro dhe rinovimi i shkollës së vjetër-20 mijë euro e në atë shkollë janë 20 nxënës e se kam të qartë se sa shkolla kemi në Brod?! Qe 5 vite, prej kur se unë jam delegat i këtij Kuvendi, gjithmonë diçka rinovohet në shkollat e Brodit e për çka është fjala?!

Kryetari- Të nderuar delegatë! Unë u mundova t'i shënoj të gjitha vërtjetet tuaja dhe më lejoj të jap përgjigje e komente në një pjesë të mjeteve të dedikuara komunitetit shumicë dhe se, qysh në fillim, patëm gabime të caktuara që disa mjete të kalojnë nga një kategori në tjetrën. Në kuptim të shumës së përgjithshme ajo mund të jetë diku 50-60 mijë euro, duke pasur parasysh se procesi i shpërndarjes së buxhetit është proces, pak sa i rëndë, dhe gjërat e tilla mund të ngjajnë. Pra, na ngel obligimi që të bëhet bartja e këtyre mjeteve të komunitetit shumicë në emër të investimeve kapitale të jo shumicës. Po ashtu, kemi rastin se gjatë korigjimit të buxhetit, në muajin mars, të bëjmë disa korigjime. U përmend edhe çështja politike e ndarjes së buxhetit e që është mendim privat nga ana e delegatëve dhe mund të them se, lidhur me shpërndarjen e buxhetit, asesi nuk ka ardhur në shprehje shpërndarja politike e mjeteve. Në kuptim të realizimit të projekteve, siç jeni në dijeni, ndonjë herë, jemë të detyruar që, projekte të caktuara, t'i ndajmë për realizim në dy faza. Lidhur me mjete të caktuara është theksuar se, nga leximi i parë dhe dytë, në disa kategori, na është lejuar shtimi i mjeteve për projekte të caktuara, që është normale. Disa memorandume, të caktuara, janë nënshkruar me intitucione përkatëse dhe na kanë lejuar shtimin e kategorive të caktuara buxhetore. Sa i përket stadiumit, ne e kemi larguar atë kategori, nga arsyeja se e kemi nënshkruar një Memorandum e MKulturës e Sportit që ata t'a finansojnë ndërtimin, vitin ardhshëm. Sa u përket diskutimeve të delegatëve, mund të filloj me radhë, dhe mund të them psh. si diskutimi i z.Laurat K. se investimet që janë paraparë, ato do të ngelin të njejta, siç janë paraparë nga qytetarët dhe fshatrat... Z.Nexhat I. përmendi pjesëmarrjen e qytetarëve, apo përfaqësuesëve të fshtrave në mbikçyrjen e realizimit të projekteve, ndoshta do të ishte, më së miri, që, kush do qoft, të merr pjesë në mbikçyrje e që është ekspert i lëmisë, por pa u cenuar baza juridike. Gjatë realizimit të projekteve, është mirë që qytetarët të japin vërejtjet, pasi se, me atë rast, mund të bëhen korigjime të caktuara e, në anën tjetër, nga komuna caktohet personi kompetent i cili përciell realizimin e pastaj themelohet Komisioni për pranim teknik të punëve të projekteve. Siç jemi në dijeni, projektet me rastin e ndërtimit të ujsjellësëve apo riparimin e tyre, janë tejet të ndieshëm dhe po ashtu jemi në dijeni se projekti i fshatit Blaç është ofruar nga vetë banorëve të fshatit dhe nuk ka asgjë të keqe që, autori i Projektit, të mbikçyrë realizimin e tij se a po realizohet sipas standardeve dhe dispozitave që kërkohen. Z.Rexhep K. ka propozuar që lidhur me fshatin e Gilloboçicës të bëhet ndryshimi i mjeteve, nga një kategori në tjetrën, në kuadër të atij fshati e që është obligimi që ky Kuvend t'a bënë me rastin e miratimit të buxhetit. Në fillim, kam thënë se 50 mijë euro nga buxheti i shumicës mund të transferohet në atë të jo shumicës e ju vetë do të jepni propozime se ku do të barten mjetet. Sa i përket SHM, ne kemi paraparë investime të përbashkëta, duke pasur parasysh se kjo është shkollë e përbashkët dhe se, çdo gabim që është përvjedhur në buxhet, nuk është i qëllimshëm. Po a shtu, nuk mund të them se, ju si përfaqësues të popullit, nu keni qenë aktiv e që jeni aktiv, edhe sot, kur e miratojmë buxhetin.. z.Sefidin M. foli për

investimet në shkollën e Kosovës e që ka të drejtë dhe ne do të tentojmë që të bëjmë gjithçka që është e mundur që gjendja në arsim të përmirësohet, përfshi edhe atë lokalitet ku investimet nuk janë të nevojshme. Kjo ngel si obligim, që të sigurohen mjete shtesë në të ardhmen, përfshi këtu edhe nevojën e sigurimit të mjeteve edhe për shkollën e Zaplluxhes. U theksua se rrugë të caktuara janë të pakalueshme, nga se projekte e filluara nuk kanë përfunduar e që ka qenë e nevojshme të vendoset, që të ndaleohen kublëzimet në vende jo publike, dhe këtu nuk ka qenë në pyetje asnjë parapavi politike, apo përcaktim politikë i qytetarëve të atyre rrugëve. Asaj që flitet reth vendosejs së kubëzave në parcela private, apo nëpër oborer private, kjo është çështje e diskutim tjetër? Sa i përket pyetjes së delegates Z.I., për asfaltimine rrugës nga Kukajani në "Fuqjamë", ky është projekt i kushtueshëm i cili duhet të merret parasysh, për të ardhmen. Sa i përket pyetjes së z.Hajrudin H. për bartjen e mjeteve, të një fshati të jo shumicës në tjetrin, unë këtu nuk mund të bëj asgjë, por që ngel në ju të vendosni si përfaqësues të popullit. Ndërkaq, lidhur me automjetin e DShëndetësisë po theksoj se kjo është nevojë dhe do të jetë për shërbime social, nga se ka nevoja për vizita nëpër familje të rasteve sociale. Z.Refik L. e përmendi propozimin që investime të caktuara të të orjentohe në lëmin e bujqësisë e turizmit e që ka të drejtë, por që, në anën tjetër, kemi të drejtën ligjore dhe obligimin që investimet kapitale mos t'i orjentojmë në zhvillim të bujqësisë e turizmit e kjo mund të bëhet në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare në kuptim të sigurimit të donacioneve, që edhe ky sektor të zhvillohet. Ne këtë po tentojmë t'a bëjmë me organizata të caktuara në kuptim të orjentimit indirekt të investimeve kapitale në rrugë kah bleshkët të cilat mundësojnë zhvillimin e bujqësisë e turizmit. Këtë jemi duke e bërë përmes organizatës Turke "Tika" dhe UNDP-së, sikurse që bënë angazhime me Mbujqësisë, përmes subvencioneve në bujqësi e blegëtori. Sa i përket fshatit Xerrxe, janë planifikuar 15 mijë euro për kubëzime dhe, me sa e di unë, atje është ndërruar udhëheqësie fshatit dhe propozimimi për ndryshim të projektit e që do të shifen arsyet, kurse ndryshimet në destinimet e projekteve bëhen nga ju delegatët? Sa i përket stadiumit, i vetmi vend ku vjen në shorëjje ai është te "Mejdani i Buzezit", ndërsa pyetjes së z.Naser M. reth kushteve në shkolla, jemi në dijeni për mungesën e pasijeve të kabineteve shkollore dhe kompjuterëve të nevojshëm e kjo do të ngjan në të ardhmen, pasi se kemi bërë identifikimin e nevojave për këto paisje. Kjo vlen edhe për rethimin e oborreve shkollore dhe rregullimin e banjove në objekte shkollore, siç kemi problemin me shkollën e Blaçit dhe tjerat për t'u evituar epidemitë e mundëshme. Me furnizimine shkollave me tekste mësimore, vërtetë, ka vonesa dhe, me siguri, problemi qëndron që, fillimisht, të përfundon furnizimi në qendrat e mëdha komunale e pastaj në ato më të vogëla se ne. Lidhur me mungesën e ZK të Pllajnikut kjo paraqet problem dhe i tejakalon mundësitë tona dhe lidhur me këtë kemi pasur kontakte me UNDP-në e cila është aktive që çështja të zgjidhet dhe më e keqja është se banorët e këtij fshati nuk po gëzojnë të drejtën për subvencione në bujqësi e blegëtori, në munges të zonës kadastrale?! Ne, për këtë, kemi kërkuar përjashtime të bënë MBujqësisë, pasi se ky fshat është blegëtoral dhe ka më së shumti sipërfaqe të mbjellua me farëra dhe mbetet të vazhdohen kontaktet që të largohen këto bariera formale. Z.Samidin Xh. dha rekomandimet, që më shumë të bëhet rreth rregullimit të ujësjellësëve, kanalizimeve, implantëve të ujit etj., por propozimet janë në bazë të atyre kërkesa që më së shumti i kanë bërë vetë

qytetarët e që, kryesisht e më së shpeshti, kërkojnë kubëzime. Sa i përket diskutimit të z.Selman O., ne vërtetë, ndajmë mjete për laboratore, si në Krushevë apo Bresanë, por që nuk janë të mjaftueshme dhe mbetet që më shumë të koncentrohemi në këto ambulanca, që qytetarët për analiza mos të vijnë në QKMF-në e Dragashit. Edhe z.Artan L. ka të drejtë kur thot se në Dragash nuk po investohet sa duhet e këtë viti kemi paraparë 60 mijë euro, kurse një organizatë, me iniciativën e qytetarëve, për Dragashin e ka hartuar një Projekt të rregullimit të qendrës komunale-nga stacioni i autobusëve e deri te Komuna, me 500 mijë euro të nevojshme të cilat do të tentojmë t'i sigurojmë nga ministritë tona. Reth furnizimit me barna, po theksoj se ekziston një memorandum me MShëndetësisë dhe mendoj se është në rrjedhë tenderi për furnizim në shumë prej 80 mijë eurove, kurse, siç dihet, nu lejohet furnizimi, nga ne, me barna esenciale, nga se kjo është obligim i Qeverisë përmes MShëndetësisë dhe unë kërkoj që të bëhet një Listë e tillë e barnave esenciale, për të ardhur në shprehje furnizimi sa më adekuat. Sa i përket vendimit për pagesën e punëtorëve, gjatë kujdestarë në shëndetësi, ky është problem jo vetëm te ne, por në mbar Kosovën dhe komunat nuk kanë mjete të planifikuara për këtë qëllim. Ne jemi në kontakt me MShëndetësisë dhe do të shifen mundësitë dhe për këtë është biseduar në Asociacionin e Komunave të Kosovës ku është thënë se komunat nuk janë në gjendje të bëjnë pagesën e plotë të shumave të nevojshme dhe është kërkuar zgjidhje përmes MShëndetësisë. Kështu kemi pengesa edhe pagesën e pagave jubilarë të punëtorëve, që paraqet problem të madh, sepse, nëse vjen te kjo, mund të reflektohet në jo stabilitetin buxhetor të Komunës, pasi se po tentojmë të zgjidhen rastet përmes gjyktave e jo përmes përmbaruesëve privat.

z.Hairudin Hoxha- S' di duket, fshatin më të madh të Gorës-Restelicën nuk u përmend fare se atje ngjau katastrofa dhe, në anën tjetër, ne si komunitet jo shumicë, do të dakordohemi për ndryshimin e projekteve, siç vlen kjo edhe për komunitetin shumicë, që të dakordohen dhe kërkoj pauzë, që pastaj të dilet me propozime konkrete.

z.Sefidin Mejzini- z.kryetar, ju për rrugët keni folur gjithmonë se ata ashtu qenkan paraparë nga "ata posht"?! Por, ata nuk i ruajnë delet e lopët, por kemi kundërthënie ligjore dhe, sipas Vendimit tuaj të vitit 2018, qëndron se mos të kubëzohen rrugët jo publike, kurse ato rrugë te ne janë paraparë dhe kanë filluar me buxhetin 2017 dhe s' di se si ju tani i interpretoni këto gjëra. Për ato punë punëkryesi i ka marr 13 mijë euro dhe sa është kjo ligjore?! Ato rrugë kanë filluar dhe janë ndërprerë e janë ndarë 30 mijë euro, duke u ndërtuar trotoarët dhe nëse ka të till kudo në Opojë e Gorë-urdhëroni e binduni e kjo është rrugë për 5 familje. Prandaj, ajo që thot kryetari "ata posh ashtu i kanë bërë" nuk duhet të qëndron, pasi se ju jeni i pari i komunës dhe e keni të drejtën të ndëshkoni e suspendoni dikend dhe ne këtu nuk shiqojnë parapavinë politike por ate humanitare. Nuk jam kundër askujt, por në Gorë nuk ka asnjë fshat me më pak se 15 mij euro të parapara e nuk janë të kënaqur e si të jam i kënaqur unë e qytetarët e mijë-Kosavës, që më kanë votuar, dhe si të votoj unë këtë buxhet?! (Pauzë)...

z.Vehbi Nazifi- Mendoj se kjo pauzë ishte e mirëseardhur, pasi se jemi dakorduar për ndryshime dhe ato janë:në Blaç mbetet siç ka qenë, pos atje ku qëndron rregullimi i ujësjetllësit të jetë pozicioni

ujësjellës e kanalizim. Në Zaplluxhe të ngel rruga e paraparë për në bjeshkë dhe të shtohet vendosja e kubëzave në rrugën kah shkolla dhe infrastruktura përcjellëse. Në Brezne, në pjesën ku qëndron 25.000 + 25.000, u morëm vesh që të jetë 15 mijë euro, për shpronësim, dhe 45 mijë euro kubëzim dhe infrastrukturë përcjellëse.

z.Rexhep Kamberi- Në bazë të tolerimeve për barazim të përqindjeve, nga 50 mijë euro të lejuara në emër të komunitetit shumicë, ne delegatët e komunitetit jo shumicë, me shumicë votash, jo të gjithë, jemi marr vesh se nga ato 50 mijë euro të shpërndahen, si vijon: Që të parashihet kod i ri- vazhdimi i rregullimit të rrjetit të kanalizimit në Restelicë në shumë prej 20 mijë eurove. Të parashihet kod i ri te numri 7-vazhdimi i kanalizimit në fshatin Rapçë me 20 (30 mijë euro) që të shtohet për 5 mijë euro dhe të jetë 25000 euro (35.000) euro, vlera e tanishme ishte 10.000 (20.000) euro, që të shtohet në 15(25.000) euro. Po ashtu, kodi numër 22 – ndërtimi i murit mbrojtës në Mlik zë shtohet nga 15 në 20 mijë euro, pra edhe plus 5 mijë euro. Në këtë mënyrë do të shfrytëzohim 50 mijë euro shtesë. Me marrvëshje tjetër të delegatëve të komunitetit jo shumicë, është vendosur që të ndryshohet pika 11 – ndërtimi i murit mbrojtës dhe kubëzimi në fshatin Gllaboçicë, që shuma prej 25 mijë eurove të zvogëlohet për 5 mijë euro etë jetë 20 mijë euro, si dhe të ndryshohet pika 12 ndërtimi dhe meremetimi i rrjetit të vjetër të ujësjellësit në fshatin Gllaboçicë, nga 15 mijë euro të tanishëm, në 20 mijë euro. Pra, këtu nuk ndryshohet shuma e tërësishme, por bëhen ndryshime. Po ashtu, kemi vendosur që të ndryshohet pika 31-vazhdimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Dikancë ne 10 në 15 mijë euro dhe kështu do të ndryshohet pika 33-kubëzimi dhe infrastruktura përcjellëse në fshatin Baçkë, nga 20 mijë në 15 mijë euro, që pra edhe Dikanca edhe Baçka do të kanë nga 15 mijë euro, e jo siç ishte deri tani-Baçka 20 e Dikanca 10 mijë euro. Ky është vendimi ynë.

z.Selman Osmani-Unë nuk do të pajtohesha me këtë paraqitje të z.Kamberi R., pasi se nuk është arritur marrvëshja. Mjetet shtesë, që na i ka premtuar kryetari, i ka paraparë nga buxheti financiar prej 50 mijë eurove, 20 mijë për meremetimin e ujësjellësit në Restelicë dhe 15 mijë euro për kanalizimin e që unë nuk do të pajtohesha, sikurse edhe për Rapçën, pasi se Rapça ka mjaft mjete prej 20 mijë eurove për ndërtimin e rrjetit të ndriçimit e çka ju nevoiten edhe 5 mijë të tjera, si dhe rregullimi i kanalizimit në atë fshat e Rapça duhet të përfiton vetëm për një çështje? Pra, nuk mund të orjentohej gjithçka në Rapçë e Restelicë, ose Restelicës të zhvogëlohen 35 mijë euro e nga Rapça 5 mijë euro, si dhe, për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe gjendjes së sigurisë, në fshatin Krushevë, në rrugën kryesore s’paku të bëhet ndriçimi publik me këto 10 mijë euro? Pra, të heqet ndriçimi publik në Rapçë dhe nga Restelica të zvogëlohen 5 mijë euro e të orjentohej në Krushevë.

z.Hajrudin Hoxha- Mos të lëshohemi në diskutime të padishme, spese për prpozimin e dhënë nga z.Rexhep K. jemi pajtuar dhe kemi votuar ne. E vërtetë, unë nuk jam pajtuar, por jam mbivotuar dhe këtë duhet t’a repsektoj e të jam parlamentar dhe nuk ka nevojë tani të lëshohemi në diskutime tjera.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është për miratimin e KABuxhetore 2019-2021 me miratimin e Vendimit për buxhetin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020 e 2021...? "për"-26, "kundër"-0 dhe "abstenim"-0, që pra, miratohet, unanimit.

z.Vehbi Nazifi- Meqenëse u zgjat mjaft, propozoj që, pika e III-të - "eventuale", të lehet ër seancën tjetër?

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Në rregull, mendoj se pajtohemni me propozimin për pikën e III-të, por ka diçka kryetari z.Shaban Shabani...

Kryetari- Edhe pse e shtytë këtë pikë, më lejoni që, shkurt, të ju njoftoj për vizitën e delegacionit të Komunës sonë në Republikën e Turqisë, përmes një shoqate të qujtur "Shkupi-Kosova" e cila merret me afrimin e komunave të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Kosovës, që e kemi marr Ftesën. Po theksoj se shumë komuna të Kosovës e kanë përfunduar këtë proces dhe i kanë bërë binjakëzimet me komuna të caktuara të Turqisë. Ne nuk mund të themi se këtë e kemi bërë, pasi se jemi në fillim të procesit të binjakëzimit, ndërsa një komunë e Burësës tash më këtë e ka bërë, por që ende nuk e kemi bërë ne. Ajo Komunë-Orhaneli është e ngjajshme me komunën tonë, sipas karakteristikave dhe numrit të banorëve e këtë mund t'a shikoni edhe në web-faqen e tyre e ne në delegacion kemi qenë me kërkesën e kryetarit të saj. Në delegacion janë ftuar unë-si kryetar, kryesuesi i Kuvendit, përfaqësuesi i partisë më të madhe opozitare, kryesuesi i Kkomunitete, si dhe një përfaqësues i shoqate apo organizate turistike. Në kontaktet që kemi zhvilluar, ata janë tejet të interesuar për bashkëpunim me ne dhe, me siguri, do të arrijnë për vizitë këthyesë në Komunën tonë. Ne i kemi dhënë sugjerimet tona dhe resurset që disponojmë dhe përgjigja ka qenë se pritet thellimi i bashkëpunimit me bashkëpunime të ndërsjella me interes reciprok.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk kemi edhe diçka, me këtë përfundojmë seancën e sotme.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu



Republika e Kosovës
 Republika Kosova/Republic of Kosovo
 Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

LISTA

E anëtarëve-delegatëve të Kuvendit Komunal Dragash
 Članova-delegata Skupštine Opštine Dragaš

Nr.seancës 9-të
 Br.sednice

Nr Br	Emri dhe mblemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu	PDK	<i>[Signature]</i>
2	Shpetim Hajredini	PDK	<i>[Signature]</i>
3	Xhemile Misinaj	PDK	<i>[Signature]</i>
4	Artan Loshaj	PDK	<i>[Signature]</i>
5	Vehbi Nazifi	PDK	<i>[Signature]</i>
6	Granit Rifaj	PDK	<i>[Signature]</i>
7	Suada Bajrami	PDK	<i>[Signature]</i>
8	Sevim Avdullahi	PDK	<i>[Signature]</i>
9	Elira Sulejmani-Krasniqi	PDK	<i>[Signature]</i>
10	Samidin Xheladini	LDK	<i>[Signature]</i>
11	Refik Latifi	LDK	<i>[Signature]</i>
12	Sefidin Mejzini	LDK	<i>[Signature]</i>
13	Naser Myrtezani	LDK	<i>[Signature]</i>
14	Arijeta Skeraj	LDK	<i>[Signature]</i>
15	Aida Misini-Halimi	LDK	<i>[Signature]</i>
16	Adelisa Krasniqi	LDK	<i>[Signature]</i>
17	Veljid Hadžisin	Vakat	<i>[Signature]</i>
18	Munir Jonuzi	Vakat	<i>[Signature]</i>
19	Zinaida Elmazi	Vakat	<i>[Signature]</i>
20	Seljman Osmani	JGP	<i>[Signature]</i>
21	Hatidža Šeh	JGP	<i>[Signature]</i>
22	Laurat Krasniqi	LVetëvendosje	<i>[Signature]</i>
23	Hajrudin Hodža	PGora	<i>[Signature]</i>
24	Nexhat Isufi	Nisma	<i>[Signature]</i>
25	Zaim Hajredini	AKR	<i>[Signature]</i>
26	Florent Rufati	AAK	<i>[Signature]</i>
27	Redžep Kamberi	GIG	<i>[Signature]</i>

Dragash dt. 26.09.2018



Kryesuesi - Prisedavajuci